

JILL SANTOPOLO
MË SHUMË SE FJALËT
ROMAN

BOTIMET TOENA

JILL SANTOPOLO

MË SHUMË SE FJALËT

roman

Përktheu nga origjinali anglisht
Enkeleida Haxhinasto

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2020

Autori: Jill Santopolo (Xhill Santopolo)
Titulli në original: More than words
Botoi në anglisht: G. P. Putnam's Sons, një degë e Penguin
Publishing Group, një seksion i Penguin Random House LLC.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Besa Vila
Korrektore letrare: Edona Marku
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-327-43-7

© 2019, Jill Santopolo
© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
Email: redaksia@toena.com.al
botimet.toena@gmail.com
www.toena.com.al

*Për babain tim,
1949-2015*

Prolog

Kishte imagjinuar që fëmija i porsalindur do të ishte djalë... Një djalë që ta merrte me vete në ndeshjet e bejsbollit apo futbollit, që të shikonin së bashku filmat e tij të preferuar, t'i mësonte makinën me marshe manuale. Një djalë që do ta vriste krijesën “xheberuok” me të, që do të merrte shpatën e tij dhe do të luftonte armiqtë e frikshëm, krah për krah të atit. Ashtu si kishte bërë ai. Një djalë që do të vazhdonte biznesin e tij, biznesin e familjes. Një trashëgimtar.

Teksa qëndronte në këmbë, me vajzën e porsalindur, që e kishte mbështetur kokën te parakrahu i tij, ndiente nevojën t'i kërkonte falje... T'i kërkonte falje, që e kishte përfytyruar djalë. Sepse nga momenti që lindi, nga momenti që e pa për herë të parë, iu duk sikur kishte mbjellë një farë në zemër. Ajo lëshoi rrënjë me shpejtësi atje... dhe tani, tri ditë më vonë, ai e ndiente që po rritej, duke e mbushur me krenari, dashuri dhe vendosmëri.

- Nina, - i pëshpëriti foshnjës së brishtë në krahët e tij. - Do të të rris të bëhesh e fortë, do të të rris të bëhesh e pushtetshme. Do të të rris të bëhesh e guximshme.

Vajza e vështronte ngultas. Sytë i kishte blu si të tije, ndërsa faqet bojë trëndafili dhe rrumbullake.

Fëmija zgjati dorën drejt tij, duke i prekur mjekrën me gishtërinjtë e saj.

Pakti ishte bërë. Marrëveshja ishte mbyllur. Dhe Xhozef Gregori do të përpiqej ta mbante këtë premtim deri në fund të jetës.

1

Ndonjëherë, Nina Gregori humbiste në elasticitetin e kohës. Kur ishte e përqendruar në diçka të rëndësishme, i krijohej përshtypja sikur koha zgjatej, ashtu si zgjatej llastiku i tendosur, derisa këputej... kur dikush që pastronte fytin apo një bori makine, e bënte kohën të dukej sërish normale.

Dhe tashmë ajo ishte përhumbur, teksa po i jepte dorën e fundit fjalimit, që do të mbante në mbrëmje shefi i saj, Rafaeli, në pritjen për mbledhjen e fondeve për fushatën. “Tani je në zonën Nina”, do t’i kishte thënë shoqja e dhomës në universitet, Lesli, nëse do të kishte qenë atje.

Kur po lexonte fjalinë e fundit, i erdhi një mesazh në celular, duke e kthyer sërish në kohën e tashme. Ishte Timi.

“Jam në një bisedë telefonike që po zgjat. Ndoshta do të vonohem 20 minuta sonte. Më vjen keq!”

“Nuk ka problem”, i shkroi Nina. “Atje do të jem.”

“Mezi po pres të të takoj”, u shfaq me shpejtësi përgjigjja e Timit në ekranin e celularit të saj.

Nina buzëqeshi. “Edhe unë.”

Timi i dërgoi një *emoji* me një fytyrë duke buzëqeshur dhe një *emoji* me gishtin e madh të ngritur lart.

Kur Timi ishte në videokonferenca, që nuk mbaronin kurrë, me kompanitë e reja për të cilat punonte, komunikonte me *emoji*. I dërgonte Ninës rreshta të tërë me ta, duke e përmbledhur ditën e tij me figura të vizatuara. Këto mesazhe gjithnjë e bënin për të qeshur Ninën. Dëshifrimi i tyre i kujtonte gjëgjëzat me fjalë dhe me figura, të cilat ata i zgjidhnin së bashku, kur uleshin në ndenjësën e prapme të makinës së babait të saj, pa e ditur që jetët e tyre do të gërshetoheshin në të ardhmen.

Teksa i përgjigjej mesazheve të Timit me *emoji*-t e saj, Xheini, zëdhënësja e fushatës, u përkul buzë tryezës ku punonte Nina.

- Do të të kërkoj një nder të madh, - i tha, teksa i thurte me njëri-tjetrin dy gërshetat e saj të vegjël. - A mund të kujdesesh ti për pritjen sonte? Para se ta përgatis Rafaelin për intervistën në kanalën televiziv "New York One", bashkë me Mekun duhet të sqarojmë disa hollësi, lidhur me pikëpamjen e Rafaelit për shkollat që financohen nga qeveria.

Nina zakonisht nuk ishte pjesë e stafit gjatë aktivitetëve. Pjesa më e madhe e shkruesve të fjalimeve nuk ishin. Por ajo do të shkonte në këtë pritje, sepse e organizonte shoqja e saj më e ngushtë e shkollës së mesme, Prisila. Në të vërtetë, këtë ia kishte kërkuar Nina, e cila ishte përpjekur të mos e merrte vesh askush nga stafi i fushatës.

- Patjetër, - vërejti, duke e drejtuar vëmendjen nga Xheini. - Jam e sigurt që mund ta përballoj. Vetëm më thuaj çfarë duhet të di!

E ndërsa Nina shtypi butonin *print* dhe e dërgoi fjalimin në *email*-in e saj, për të pasur një kopje rezervë, Xheini i dha disa udhëzime:

- Mia i ka vënë punët në vijë, kështu nuk ke pse shqetësohesh aspak për logjistikën. Detyra jote është, që kur ta takosh Rafaelin me donatorët, t'i japësh një informacion, që ai mund ta përdorë për të hyrë në bisedë. Kam një listë të të ftuarve, fotografitë e tyre dhe gjithçka që dimë për ta. Do të ta dërgoj. Por, ndoshta, mund t'ia dalësh edhe pa listën.

Nina pohoi me kokë.

- Sigurohu që të ketë gjithnjë një pije në dorë dhe ajo të mos jetë e fortë! - vazhdoi Xheini. - Atij i pëlqen soda me vodka, me një fetë limoni. - Ajo i numëronte me gishta këshillat që i jepte. - Dhe sigurohu që askush mos t'i marrë shumë kohë. Mia do t'i ketë gati çantat e dhuratave, kështu që nuk ke pse shqetësohesh as për këtë. Ajo mund të të ndihmojë, nëse do të kesh nevojë.

Nina pohoi sërish me kokë.

- Kuptoj, - mërmëriti.

- Të siguroj që nuk është e vështirë. - Xheini u largua nga tryeza e Ninës.

- Mos ki merak! - e qetësoi Nina, teksa mori çantën dhe xhaketën. - Çdo gjë do të shkojë mirë.

Rrëmbeu fjalimin dhe u drejtua për nga korridori. Rafaeli po priste tek ashensorët. Kravatën e kishte lidhur në mënyrë shumë simetrike, ndërsa xhaketën gri të kostumit e kishte palosur me kujdes mbi krah.

- Pra jemi vetëm ne të dy? - iu drejtua Ninës, që ndaloi pranë tij, duke mbërthyer xhaketën.

- Kështu më thanë edhe mua. - Ajo ngriti sytë, ndërsa ai buzëqeshi.

Gazeta “The Daily News” kishte shkruar dy herë për buzëqeshjen e Rafaelit, duke e quajtur “elektrizuese” dhe “të parezistueshme” si dhe pjesë të “përpyjekjes së Rafael O’Konor Ruizit për të shfrytëzuar sharmin e tij gjatë fushatës”. Dhe Nina e kuptonte përse... Seç kishte diçka në buzëqeshjen e tij... Natyrshmëria, mënyra si i picërronte sytë apo si i dilnin në pah dy rreshtat me dhëmbë, nuk të linin mundësi tjetër përveçse t’ia ktheje buzëqeshjen.

- Mendoj që do t’ia dalim, - vërejt i ai, teksa kaloi dorën e majtë nëpër flokët e zinj e të dendur.

Deri vjeshtën e kaluar Rafaeli kishte punuar si avokat i imigracionit. Ai mbronte të drejtat e njujorkezëve, që përballëshin me deportimin. Më pas, Rafaeli u nda nga bashkëshortja, u shkëput nga firma ku punonte dhe në janar shpalli kandidaturën për kryetar bashkie të qytetit të Nju-Jorkut. Tashmë kishin kaluar katër muaj. Nina ishte personi i katërt që ai kishte punësuar pas Xheinit, Mekut, që ishte drejtuesi i fushatës dhe Kristianit, që ishte përgjegjës për mbledhjen e fondeve.

- Kam besim të plotë te ne të dy, - e mbështeti Nina.

Ashensori erdhi në momentin që ajo mori një mesazh nga Xheini.

- Makina jonë është jashtë, - tha Nina. - Xheini më porositi t'ju kujtoj, që shoferi quhet Frenk. Ai ju ka çuar në shtëpi javën e kaluar dhe është tifoz i ekipit të bejsbollit “Yankees”.

- Frenk, - përsëriti Rafaeli. - Tifoz i “Yankees”. Po. E mbaj mend.

Ai, që në mbledhjen e parë, ua kishte bërë shumë të qartë drejtuesve të stafit, se donte të dinte emrin e çdo personi që do të takonte gjatë fushatës, në mënyrë që të ishte i saktë, kur t'i drejtohej për t'i përshëndetur apo falënderuar, sepse dëshironte që secili të ndihej i vlerësuar, pavarësisht nga puna që bënte. “E kuptoni sa e bezdisshme do të jetë kjo?”, ishte ankuar Meku pas përfundimit të mbledhjes.

Ndërsa Ninës i kishte pëlqyer shumë kërkesa e Rafaelit. Në të vërtetë, ajo i kujtonte të atin, i cili dinte emrin e çdo baristi apo punonjësi shërbimi që punonte në hotelet “The Gregory”.

“A të ka shkuar ndonjëherë nëpër mend, se ndoshta edhe ti duhet t'i dish emrat e këtyre njerëzve?”, Xheini i ishte përgjigjur me një kundërpyetje Mekut atëherë.

Nina e kishte fshehur të qeshurën me një të kollitur, por që nga ajo mbledhje e parë ajo anonte gjithnjë nga Xheini, sa herë i duhej të merrte anën e njërit prej tyre. Dhe kënaqej, që edhe Rafaeli dukej se kishte këtë përshtypje.

2

- Pra, ti i njeh organizatorët e kësaj pritjeje? - e pyeti Rafaeli Ninën, kur ashensori po zbriste dymbëdhjetë katet.

Ajo pohoi me kokë.

- Prisila Uinter dhe Brent Filding. Unë dhe Prisi kemi qenë shoqe, që nga koha e kopshtit deri në përfundim të shkollës së mesme. Familja e saj e vuri pasurinë me industrinë e çelikut, ndërsa tani merren me bioteknologji. Brenti drejton një fond investimesh. Ai është rritur në Boston.

Dera e ashensorit u hap. Ata dolën nga holli dhe u drejtuan për te makina që po i priste.

- Frenk! - tha Rafaeli, kur pa shoferin që po qëndronte te dera e makinës. - Gëzohem që të takoj sërish. Të falënderoj që je kaq i përpiktë.

- Kjo është puna ime, zotëri, - u përgjigj Frenku, duke hapur derën për Ninën. Pastaj vajti në anën tjetër dhe e hapi për Rafaelin.

Nina vështroi përreth ndenjësës së prapme. Ujë. Shami letre. Por karamelë nuk kishte. Shoferët e saj të preferuar ishin ata që sillnin karamelë me gjalpë.

Kur u futën në trafikun e qytetit të Nju-Jorkut, Nina i dërgoi Mias vendndodhjen me celular, në mënyrë që ata të ndiqnin lëvizjen e tyre në rrugët e qytetit. Pastaj i zgjati Rafaelit kopjen e printuar të fjalimit. Teksa e përsëriste me mend, ai lëvizte buzët dhe bënte gjeste me duar. Dukej sikur gjestet ishin arti i tij i interpretimit.

Nina u mbështet në ndenjësë, duke e vështuar teksta praktikonte fjalët e saj. Me shpatullat e gjera dhe vrimën në mjekër, ai dukej si imazhi hollivudian i politikanit. I bukur, tërheqës. Por ai ishte edhe i shkëlqyer. Ninës i pëlqente shumë të gjente fjalët e sakta për të shprehur idetë dhe pasionin e tij, fjalët e duhura që do ta ndiznin audiencën. Por pas fasadës së tij të përsosur, pas buzëqeshjes elektrizuese, ai ishte një enigmë. “Çfarë po mendon?”, dëshironte ta pyeste ajo ndonjëherë.

I erdhi sërish një mesazh në telefon. Nina uli sytë, duke menduar se ishte nga Xheini ose ndonjë tekst i mbushur me *emoji* nga Timi. Por ishte babai i saj.

“Gruaja që mbante titullin profesoreshë, të sponsorizuar nga gjyshja jote në Universitetin *Smith*, do të dalë në pension dhe ka një pritje pas gjashtë javësh. Ata më kërkuan të mbaj një fjalim, por nuk mendoj se duhet të planifikoj kaq kohë përpara. A mund ta konfirmosh pjesëmarrjen në vendin tim, zemër? Po të dërgoj adresën e *email-it*.”

Nina lexoi fjalët. Pastaj i lexoi përsëri. Ndonëse të thëna me shumë dashamirësi, ajo ndjeu një shtrëngim

në gjoks, sa mezi po merrte frymë. “Nuk mendoj se duhet të planifikoj kaq kohë përpara.”

Çdo moment të çdo dite, ajo përpiquej ta hiqte mendjen nga fakti që babai i saj ishte i sëmurë. Që mjekët kishin thënë se kësaj here nuk mund të bënin dot asgjë. I kishte dhembur shpirti, kur e kishte parë të bënte kimioterapi tri vite më parë. Por atëherë, të paktën kishte shpresë... kishte shpresë që ende do të kalonin ditë së bashku, duke lundruar me anijen e tyre në Oqeanin Atlantik, do të kalonin mbrëmje së bashku, duke pirë uiski në tarracën e hotelit të tyre, në jug të *Central Park*-ut. Tani, nuk kishte më... Kjo ishte arsyeja, pse Nina përpiquej kaq shumë t’i largonte këto mendime.

Por kur ai dërgonte mesazhe të tilla, kjo ishte e pamundur...

Pas shtrëngimit në gjoks, ndjeu sytë t’i mbusheshin me lot. Si ishte e mundur? Nina nuk e kishte lejuar më kurrë veten të qante. Përpara askujt. Madje as para Timit. Solli nëpër mend sende, që nuk i krijonin emocion, në mënyrë që t’i mbante ndjenjat e saj nën kontroll. “Pirunë, llamba, guralecë.” Por ndonëse luftoi me lotët, kësaj here nuk mundi t’i ndalte dot... Vështroi përqark makinës. Nuk kishte nga shkante... që të ishte vetëm... Nina rrufiti hundët pa zhurmë, duke shpresuar që Rafaeli nuk do ta vinte re lotin që po i rridhte në faqe.

Ai ngriti sytë nga celulari.

Nina u kthye dhe e fshehu fytyrën. “Mami”, mendoi, duke dërguar një mesazh në hapësirë, “të lutem më ndihmo! Të lutem më jep forcë dhe më mbaj të përqendruar! *Fuerte y centrado. Fuertrado*”. Që kur ishte tetë vjeçe, ajo kishte filluar të bisedonte me të ëmën në mendjen e saj, në momente që vërtet nuk dinte nga t’ia mbante. Zakonisht kjo e ndihmonte.

- Çfarë ke Nina? - e pyeti Rafaeli me një zë të butë, që ajo nuk e kishte dëgjuar më parë. - Mirë je?

Ajo mbylli sytë, duke e përkulur kokën prapa, thua se forca e gravitetit do t’ia pengonte lotët. Por ato i rrodhën nga poshtë qepallave.

- Hej, a mund të të ndihmoj me ndonjë gjë?

Nina mori frymë thellë. U përpoq sërish. “Peceta prej letre, lugë plastike, kruese të drunjta dhëmbësh.” Mendja e saj po kthjellohej. Hapi sytë dhe i fshiu lotët me majat e gishtave.

- Më fal! - Ktheu fytyrën nga ai. - Ishte babai im.

Për një çast, Rafaeli nuk foli. Vendosi ngadalë dorën e tij mbi të sajën, sikur të donte t’i thoshte: “Jam këtu me ty. Të kuptoj”. Nuk ishte diçka që ajo e kishte pritur. As kallot në mollëzat e gishtave të tij, sikur të ishte kitarist. Kishte kaq shumë gjëra që nuk i dinin për njëri-tjetrin. Megjithatë, ngrohtësia e gishtave të tij e përmirësoi disi situatën. Ajo buzëqeshi lehtë.

- Të kërkoj ndjesë për këtë, - mermëriti, duke kërkuar në çantë për një shami letre. - Sapo më dërgoi babai një mesazh dhe më kërkoi të mbaj një fjalim në

vend të tij, sepse nuk është i sigurt, nëse do të mund ta bëjë dot vetë... Dhe kjo më zuri në befasi.

- Jeta ime ishte lëmsh, ndërkohë që babai ishte i sëmurë, - vërejtji Rafaeli. - Më ka bërë shumë përshtypje, që ti e ke mbledhur veten këta muajt e fundit.

Nina e dinte që babai i tij kishte vdekur pesë vjet më parë nga infarkti kongjestiv. E dinte tërë biografinë e tij. Por kishte imagjinuar, që ai i kishte bërë ballë atij hidhërimi me të njëjtin pragmatizëm, që kishte përballuar edhe divorcin. Gjatë muajve, që e kishte njohur Rafaelin, kishte parë tek ai të gjitha aftësitë dhe pasionin për ta përmirësuar qytetin. Por emocionet ai i kishte kyçur, i kishte mbajtur të fshehta. Ose ndoshta thjesht i kishte ruajtur për njerëzit jashtë zyrës.

- Nuk më pëlqen ta kem jetën lëmsh, - pëshpëriti ajo.

Ai pohoi me kokë me dhembshuri.

- Diçka si kjo, - vërejtji ai ngadalë, - të detyron ta shohësh botën ndryshe. Mendoj se është e pamundur të mos zhgënjehesh, kur këndvështrimi yt për jetën ndryshon.

Nina e vështroi e habitur. Rafaeli kishte shprehur me fjalë një ndjesi, që ajo ishte munduar për javë të tëra t'ia shpjegonte Timit.

- Është pjesë e çdo vendimi që marr tani. Përpiqem ta harroj, por ajo është aty... është qendra e vëmendjes sime që kufizon zgjedhjet e mia...

Më në fund, gjeti një shami letre dhe e përdori për të fshirë tualetin e syve. Pastaj pa një kuti plot me shami të tilla që kishte qenë gjatë gjithë kohës te dera e makinës.

- Motra ime ishte shtatzënë, kur babai po vdiste, - i tregoi Rafaeli. - Ajo më thoshte se çdo vendim që merrte për mbesën time, që nga emri i saj e deri te mobilimi i dhomës, filtroheshin në idenë se babai mund të mos e takonte kurrë atë. Kjo është arsyeja pse emri i mbesës është Emilia.

- Babai yt quhej Emilio, - mërmëriti Nina.

Rafaeli pohoi me kokë.

- Motrës gjithnjë i kishte pëlqyer emri Tifani. Nëse babai nuk do të kishte qenë i sëmurë, jam i sigurt që mbesa do të ishte quajtur Tifani. Ky është një shembull i thjeshtë, por..., - Rafaeli mblodhi supet. - Më vjen keq që të duhet ta përjetosh këtë. - Ia mori përsëri dorën dhe ia shtrëngoi fort, duke i treguar në heshtje: "Të kuptoj. Edhe unë jam ndier kështu". Këtë e thoshin edhe sytë e tij.

- Më vjen keq që të është dashur ta kalosh këtë dy herë, - vërejti ajo, duke menduar për ish-gruan e tij.

- Mamaja ime jeton, - u përgjigj Rafaeli.

Nina buzëqeshi.

- E di. E kisha fjalën për Sonian. Për dikë tjetër, që nuk është më në jetën tënde..., që ti e humbe...

Rafaeli e vështroi për pak çaste, sikur po peshonte fjalët e saj... sikur po peshonte të tijat...

- Nuk kisha menduar ndonjëherë për divorcin në këtë mënyrë, - ia ktheu. - Por ke të drejtë! Pikëllimi, tronditja, qartësimi i emocioneve. Nuk është gjithçka e njëjtë, por shumë gjëra...

- Besoj se këndvështrimet tona për jetën po ndryshojnë tashmë.

- Edhe unë e besoj këtë, - mermëriti Rafaeli dhe ia shtrëngoi dorën edhe një herë.

3

Kur Mia u takua me Ninën dhe Rafaelin përpara klubit “Norud”, flaka që u ndez midis tyre tashmë ishte shuar. Por diçka kishte ndryshuar. Kur zbritën nga makina, Rafaeli e priti Ninën, që t’i ngjisnin shkallët së bashku. Ajo ndihej më pak si ndihmësja e tij dhe më shumë si... nuk ishte e sigurt se çfarë... si një kolege ose ndoshta edhe një shoqe.

Një bionde imcake, që mbante në dorë një gotë shampanjë, iu hodh në qafë, kur u futën brenda.

- Pris! - tha Nina, duke qeshur. - Gëzohem shumë që po të shoh.

- Çdo gjë në rregull? - i pëshpëriti Prisi në vesh. - Dëgjova që babai yt këtë javë ka shkuar rrallë në zyrë.

- Mirë është, - gënjeu Nina dhe e përqafoi shopen. - Ka punuar nga shtëpia.

- Oh, shyqyr, - u qetësua Prisi. - Do t’i them tim ati. Ai kishte një vend të lirë në një turne pokeri për bamirësi, të mërkurën, dhe shpresonte të vinte edhe babai yt.

Nina pohoi me kokë dhe u kthye nga Rafaeli, i cili po i vështronte të dyja qetësisht.

- Pris! Ky është Rafael O’Konor Ruiz. Rafael, Prisila Uinter. - Pastaj iu kujtua udhëzimi i Xheinit. -

Prisila dhe Brenti do të shkojnë në Kanë për festivalin e filmit.

Rafaeli zgjati dorën.

- Ju falënderoj shumë për këtë pritje, - i ndriti fytyra nga buzëqeshja e tij elektrizuese.

Edhe Prisila buzëqeshi.

- Oh, është kënaqësi për ne! Kur Nina na thotë, që një kandidat meriton të mbështetet, ne e dëgjojmë.

Nina u struk. E vërteta kishte dalë në shesh. Rafaeli e vështroi dhe ngriti njërin vetull. Pastaj u kthye nga Prisi. - Më tregoni pak për udhëtimin në Kanë!

Erdhi edhe Brenti. Ai dhe Prisila filluan të bisedonin me Rafaelin, ndërsa Nina i bëri shenjë kamerieres. Porositi një *Sauvignon Blanc* për vete dhe një koktej me pak vodka.

Nina iu afrua disa grave të tjera, që i njihte nga bordi i Baletit të Nju-Jorkut, ku kishte punuar bashkë me Prisin.

- Kur do ta shohësh “The Balanchine”? - e pyeti Megi Lanseri, pasi e përqafoi. - Kam dëgjuar që është fantastike.

- Unë dhe Timi kemi marrë bileta për muajin e ardhshëm, - u përgjigj Nina. - Por dëgjova që shfaqja “Romeo dhe Xhulieta” këtë verë, do të jetë edhe më e mirë. Balerini Zakari do të interpretojë Romeon.

- Zakari është i jashtëzakonshëm, - vërejti Megi. Pastaj vuri re një çift që hyri në sallë. - Oh, erdhi Heili! Më duhet të flas me të për darkën që do të organizojmë fundjavën tjetër.

Kur Megi u largua, Nina i hodhi një sy Rafaelit. Një turmë e vogël ishte mbledhur rreth tij dhe të gjithë po qeshnin me diçka që ai kishte thënë. Nuk mund të mohohej sharmi i tij, aftësia për t'i tërhequr njerëzit drejt vetes. Por në të njëjtën kohë, Ninës iu duk sikur miqtë e saj po e trajtonin atë si zbatimësin e mbrëmjes. Kjo e bëri të ndihej paksa e sikletosur.

Në momentin që po matej të ecte në drejtim me të, ndjeu dikë ta mbështillte me të dy krahët dhe ta puthte në kokë. Mori frymë thellë. Shampo “Redken”. Sapun “Shea Butter”. Krem rroje “Sandalwood”. Qëkur kishte filluar të rruhej, aroma e Timit ishte krejtësisht e njëjta: një përzierje e këtyre të triave. Kjo ishte një nga cilësitë më ngazëlluese të Timit. Ai ishte produkt i zakoneve të tij. Nina mund ta parashikonte atë që do të gjente në frigoriferin e tij, në secilën nga ditët e javës. Ajo mund t'i blinte edhe veshjet: xhinse “Brooks Brothers”, me prerje të ngushtë, në ngjyrë të kaltër të errët, këmisha me viza, pulovra me jakë “V” dhe xhaketa sportive ngjyrë blu, ku do t'i ngjitej çamçakëzi me mente, gjithnjë i markës “Eclipse”, i mbështjellë me një letër të hollë ngjyrë argjendi. Me Timin nuk kishte kurrë surpriza dhe kjo ishte një nga gjërat që i pëlqente më shumë tek ai.

Nina u rrotullua dhe zuri vend poshtë mjekrës së tij.

- Më fal që u vonova, - i pëshpëriti me buzët pranë flokëve të saj.

Ajo u ngrit në majë të gishtave për t'i dhënë një puthje.

- Nuk je vonuar aspak, - mërmëriti Nina. - Mos u merakos për këtë!

- Faleminderit. - I shtrëngoi supin me një rëndë dorë, ndërsa me tjetrën i bëri shenjë një kamerieri. - Vetëm verë sonte? - e pyeti.

- Jam duke punuar. - Ajo mblodhi supet. - Dëshiron ta takosh shefin tim?

- Sigurisht. Kam dëgjuar shumë për të.

Sapo Timi porositi dhe përshëndeti disa miq të tyre, ajo e shoqëroi te Rafaeli. Ai po bisedonte me Prasilën dhe me një nga shokët e punës së Brentit.

- Tim, - thirri Prisi, kur u afruan. Ajo e përqafoi dhe e puthi në faqe.

- Rafael, ky është i dashuri im, Tim Kalder. Tim, shefi im, Rafael O'Konor Ruiz.

Dy burrat shtrënguan duart.

Prisi vështroi Ninën, që po qëndronte pranë Timit dhe vuri buzën në gaz.

- E kisha parashikuar këtë, - i tregoi Rafaelit. - Që në shkollë të mesme, e dija që këta të dy do të përfundonin së bashku. Duket... duket sikur kanë lindur për njëri-tjetrin.

- Oh? - pyeti Rafaeli.

- Baballarët tanë kanë qenë shokë dhomë në universitet, - shpjegoi Nina, ndërsa Timi tha:

- Jemi rritur bashkë.

- Babai i Timit është drejtor ekzekutiv i kompanisë së babait të Ninës, - shtoi Prisi. - Pra ata janë tashmë si familje.

Rafaeli buzëqeshi, por buzëqeshja e tij nuk ishte ajo e gazetës “Daily News”.

- Duhet të jetë bukur të jesh me dikë që di gjithçka për ty, - tha ai.

Nina ngriti sytë për të parë Timin. Ai ndoshta dinte gjithçka për të. Ose të paktën, aq shumë sa mund të dinte një njeri për një tjetër. Ajo pyeti veten, nëse buzëqeshja e Rafaelit ishte venitur, ngaqë nuk ishte ndier kështu për ish-gruan e tij.

- Nuk i ke takuar ende Lenserat? - e pyeti Nina.
- Ata ishin donatorë të mëdhenj gjatë zgjedhjeve presidenciale.

- Më çò tek ata! - Kësaj here buzëqeshja iu shtri në të gjithë fytyrën. Megjithatë, ajo arriti të kuptonte një ndryshim të vogël, por të dallueshëm: nganjëherë ajo buzëqeshje ishte e vërtetë dhe nganjëherë për mirësjellje.

Teksa Nina e shoqëroi Rafaelin në drejtim të Lenserave, ai i hodhi një vështrim të shpejtë Timit.

- I dashuri yt duket i këndshëm.

- Faleminderit, - ia ktheu Nina. - Ashtu është.

* * *

Atë mbrëmje të vonë, kur ishte në shtëpinë e Timit dhe po lante dhëmbët me furçën elektrike që ia kishte blerë ai, Nina mendoi për fjalën “i këndshëm”. Ishte një mënyrë shumë e mirë për të përshkruar dikë, madje ishte edhe një kompliment. Por ajo fjalë iu duk e vakët. E mërzitshme. Kështu e shikonte Rafaeli Timin. Ajo u çudit sa shumë e shqetësoi kjo...

Njujorkezët e rrethit të Ninës dhe të Timit hanin *brunch*, mëngjes e drekë bashkë, të dielave. *Brunch*-i ishte një traditë e qytetit. Ishte një fenomen kulturor, që lidhte brezat e shoqërisë. Dhe *brunch*-i i së dielës, në hotelin “The Gregory on the Park”, ishte legjendar. Gjyshi i Ninës e kishte përgatitur personalisht menynë, kur e hapi hotelin, në fillim të viteve 30-të. Ishte me katër pjata. Madhështor. Dhe shërbehej me shampanjë. Turistët e dinin se, nëse donin çajin më të mirë të pasdites në Nju-Jork, ata shkonin në restorantin “Palm Court”, në hotelin “The Plaza”. Dhe nëse donin *brunch*-in më të mirë të së dielës, ata shkonin në restorantin “The Groove”, në hotelin “The Gregory on the Park”.

Kur Xhozef Gregori e mori hotelin në vitet 80-të, ai vendosi të shtojë edhe një *brunch* të shtunën. I pari ishte të shtunën e tretë të janarit të 1989-ës. Nina ishte tri vjeçe, ndërsa Timi pesë. Ata ishin ulur me prindërit e tyre në tavolinën kryesore pranë derës dhe përshëndetnin të ftuarit që mbërrinin. Të ftuarve

u pëlqente të hanin *brunch* në të njëjtën sallë me Xhozef Gregorin. Nina ia atribuonte këtë pjesërisht magjepsjes së njerëzve pas pasurisë, dhe pjesërisht babait të saj si figurë publike. Ai ishte milioneri i dashur, që kënaqej tek bisedonte jo vetëm me pronarët e “Yankees”, por edhe me tifozët e tyre. Nina e dinte që kjo nuk ishte krejtësisht e vërtetë, por ishte ajo që mendonin të gjithë. Ishte e vërteta e tyre.

Bëri shumë bujë vendimi i babait të saj për të qenë i pranishëm në *brunch*, të shtunën e tretë të çdo muaji, pas këtij të parit, me përjashtim të korrikut, kur ai ishte në *Hemptons*. Nina dhe mamaja e saj e kishin shoqëruar, derisa mamaja vdiq. Më pas kishte shkuar Nina me të atin, gjer kur iku në universitet. Pastaj, babanë e saj e kishin shoqëruar prindërit e Timit, Tixhei dhe Kero. Tani, Nina dhe Timi vinin kur kishin mundësi.

Timit i pëlqente të ulej në tavolinën qendrore, t’ua bënte me dorë fëmijëve që hynin brenda, apo të përshëndeste me kokë të rriturit. Ndërsa Ninës jo. Që kur ishte kthyer në qytet, pas përfundimit të universitetit, ajo ndihej e sikletosur në këto *brunch*-e, tek qëndronte në krye të vendit, e veshur elegante. Por e dinte që kjo ishte e nevojshme për biznesin dhe e rëndësishme për babanë e saj, prandaj asnjëherë nuk iu qa askujt. Përveç Leslit, e cila e inkurajonte të kundërshtonte, duke u shfaqur një ditë me xhinse të grisura. Nina nuk e kishte bërë kurrë këtë, por e mendonte shpesh.

Kur ajo dhe Timi hynë brenda në restorantin “The Grove”, atë të shtunë, në sallën e mbushur me të njëjtët shandanë me hekur të punuar dhe të njëjtat dekore të ndërlikuara, që kishte zgjedhur gjyshi i saj, babai i Ninës u ngrit nga karrigia. Ai e njihte mirë sallën. E dinte vendin e tij, ku mund të bënte më tepër përshtypje, pikërisht aty ku i binte një rreze drite dhe ku dukej sikur rrëzëllente. Nina iu afrua dhe e përqafoi fort. Ajo nuk i vuri re celularët që po u bënin fotografi, por shijoi aromën e kolonjës së tij: duhan, lëkurë dhe trumzë, që përmbliidhte atë që ai ishte në thelb.

- “Xhozef Gregori, i emocionuar tek takon vajzën e tij për *brunch*”, - i ati i sugjeroi një titull për fotografitë që po bënin të ftuarit, të cilat do të pushtonin faqet e para të gazetave. Ishte një lojë që ai e kishte krijuar, kur Nina ishte fëmijë, duke sajuar titujt më të mirë dhe më të tmerrshëm të mundshëm, që përshkruanin momente të caktuara të jetës së tyre. Kjo e ndihmonte Ninën të kuptonte pasojat dhe koston që kishin. Por, qëkur i ishte kthyer kanceri në janar, ai nuk kishte mundur ta formulonte titullin më të tmerrshëm... Ajo e përqafoi edhe më fort, pa u shqetësuar për shfaqjen që po jepnin për të ftuarit.

- Të dua! - pëshpëriti ajo.

- Më shumë se fjalët. - Kjo kishte qenë përgjigjja e tij, gjatë gjithë jetës së Ninës.

Ata u ulën. Nina në të majtë të të atit, ngjitur me Timin, dhe pas Timit, Tixhei dhe Kero. Nina pushoi

së foluri për një çast, për të ruajtur në mendjen e saj një fotografi të këtij momenti. Dëshironte ta kujtonte këtë... Babanë e saj në krye të familjes dhe të miqve të tij.

- Si po shkon fushata? - e pyeti ai.

E kishte pasur gjithnjë të vështirë të fliste për politikë me të atin. Nina kishte dëgjuar një bisedë, që ai kishte bërë një herë me Tixhein, lidhur me punën e saj. “Ajo po kalon një fazë idealiste”, ishte shprehur i ati.

Kjo e kishte detyruar të rivlerësonte atë që po bënte, të pyeste veten, nëse gjithkush mendonte që ajo po bëhej qesharake, duke punuar për një politikan, në vend që t’i bashkohej korporatës “Gregori”, menjëherë pas përfundimit të shkollës së biznesit. Por ajo vendosi që, edhe nëse ai kishte të drejtë, nuk do të ndryshonte mendim.

Puna në politikë e bënte Ninën të ndihej si një përfaqësuese e ndryshimit. Këtë ndjesi nuk do të mund t’ia jepte kurrë biznesi i hotelierisë. Kur kishte punuar vullnetarisht në fushatën për rizgjedhjen e kryetarit të bashkisë së New Heaven -it, kur ishte në universitet, kishte rënë në dashuri me punën e saj si shkruese fjalimesh. Ajo kishte qenë e pranishme në debate politike dhe më pas ishte përpjekur t’i përmblidhte idetë me fjalët e duhura, për të gjetur një mënyrë që të ndryshonte mendjet e njerëzve. Kjo ishte një sfidë, një lojë ku rrezikohej shumë. Ajo dhe ekipi i kryetarit

të bashkisë kishin fituar. Biznesi nuk ia kishte dhënë kurrë Ninës atë lloj euforie.

- Mirë, - u përgjigj ajo. - Jemi fare afër me Mark Xhonsonin.

I ati piu një gllënjë kafe. Ai kishte bërë një donacion në fushatën e Mark Xhonsonit, katër vjet më parë.

- Më thuaj kur të jetë e sigurt, që do të fitojë.

Nina rrëshqiti dorën mbi pecetën në prehrin e saj.

- Patjetër, - mermëriti.

Xhozef Gregori i mbështeste fituesit, pavarësisht nga partitë që përfaqësonin apo donacionet e mëparshme.

- Sidoqoftë, do të votoj për të në zgjedhjet paraprake, - shtoi ai.

- Vërtet? - e pyeti Nina, e habitur.

- Sigurisht, - iu përgjigj i ati. - Do të bënim përshtypje të mirë, nëse ti do të zgjidhje fituesin.

Sa herë që emri “Gregori” lidhej me një sukses, ai bëhej më i fuqishëm dhe mbetej në mendjet e njerëzve. Kjo ishte diçka që gjyshi i saj e kishte thënë gjithnjë, diçka që babai i saj e kishte përsëritur: “Emrat kanë domethënie. Dhe ti nuk je asgjë pa emrin tënd”.

- Le të shpresojmë! - mermëriti ajo, duke marrë një simite të vogël nga shporta e tejmbushur e bukës. - A do të kemi këtë javë ndonjë gjë interesante në hotel?

- Do të ndërrojmë zambakët “kala” me trëndafila, - i shpjegoi Kero, duke vështruar përreth vazot me lule

që mbushnin restorantin. Ajo organizonte të gjitha eventet në të dyja hotelet “Gregori”, që përfshinin edhe ndryshimin stinor të luleve, në restorantin “The Grove” dhe në restorantin “The Garden”, në hotelin që ndodhej në qendër. Lulet e vjeshtës ishin krizantemat, dimri sillte luleborat, në pranverë vendoseshin zambakët “kala” dhe në verë trëndafilat. Gjyshja e Ninës ishte angazhuar vetë në fillim, ndërsa tani Kero kishte punësuar një specialist lulesh. Ato ndërroheshin çdo javë, të premtën, herët në mëngjes, përpara se restorantet të hapeshin për vaktin e mëngjesit.

Ajo u kthye nga Nina.

- Ke dëshirë të vish t’i shikosh?

Kur ishte fëmijë, Ninës i kishte pëlqyer t’i shihte bashkë me të ëmën kur ndërroheshin lulet. Me mijëra lule, që mbushnin restorantin me aromën dhe ngjyrën e tyre. Dukej si një ceremoni jashtëzakonisht e bukur, për të mirëpritur një stinë të re.

- Do të ishte shumë argëtuese, - u përgjigj ajo. - U bë kohë që nuk kam ardhur t’i shoh.

- Oh, shkëlqyeshëm! Mund të të rrëmbej për mëngjes më pas?

Timi pastroi fytyrën.

- Hëm! Po unë?

Nina i ra me bërryl në sup, duke qeshur.

- Ke frikë se mos flasim për ty? Unë dhe mamaja jote kemi edhe tema të tjera për të biseduar. - Kero i ishte gjendur gjithnjë pranë Ninës. Ishte ajo që kishte

folur me të, se si do të ishte hera e parë, kur t'i vinin menstruacionet. Ishte ajo që e kishte shoqëruar për të blerë fustanin për të dyja mbrëmjet e fundvitit në shkollën e mesme. Kero ishte siguruar që ajo të merrte kontraktivë, para se të shkonte në universitet, edhe pse iu desh të bindte babanë e Ninës.

Kero i futi prapa veshit flokët e saj të shkurtër biond dhe të thinjur. “Biond si rëra e ishullit të Nantakit”, filloi t'i quante ajo, kur ngjyra ndryshoi në të bardhë.

- Patjetër që je i mirëpritur, Timothi, - iu përgjigj të birit. - Atëherë do të shihemi të premtën, në orën 6:00 të mëngjesit.

- Kaq herët? - tha Timi duke rënkuar. - Nuk mund t'i ndryshoni lulet, për shembull, në orën 8:00?

Nina filloi të qeshte. Tixhei tundi kokën.

- Bir, - mërmëriti. - Si do t'ia bëjmë ne me ty?

Babai i Ninës, që po e dëgjonte këtë bisedë me një buzëqeshje në fytyrë, qeshi mbyturazi. Por pastaj i filloi një kollë, që nuk po i pushonte. E qeshura e Ninës u shua.

- Baba! - i foli me zë të ulët. - E ke marrë aparatën e frymëmarrjes me vete?

Ai pohoi me kokë, pastaj vështroi përreth sallës.

- Nuk e përdor dot këtu. - u kollit sërish. - Kthehem shpejt.

U ngrit dhe u përpoq të mos tërhiqte vëmendje me kollën. Doli nga dera e restorantit dhe u drejtua për në banjë.

- Po shkoj të shoh, nëse ka nevojë për ndihmë.

Tixhei u ngrit.

Kero, Timi dhe Nina qëndruan të ulur në heshtje. Nina u ndie njësoj si në makinë me Rafaelin. Sikur degët e hardhive të ishin mbështjellë rreth kafazit të saj të kraharorit dhe nuk e linin të merrte dot frymë. Kero e pa dhe e lexoi fort mirë situatën.

- A do ta bëjmë shëtitjen tonë deri në tualet, ne vajzat? - pyeti ajo. Pastaj foli butësisht, sikur të mos i pëlqente aspak ajo që do të thoshte, por e dinte që duhet ta bënte. - Nuk derdhen lot përpara të ftuarve. - Ishte diçka që babai ia kishte kujtuar shpesh Ninës kur ishte fëmijë, por për shumë vite nuk kishte qenë e nevojshme ta bënte më...

Ajo mbylli sytë për një çast. Qetësoi panikun. Largoi frikën. Dhe ashtu siç kishte bërë, kur ishte tetë vjeçe, në muajt pas vdekjes të së ëmës, u lut që zemra e saj të ishte e pathyeshme. Ata po jepnin një shfaqje dhe në këtë shfaqje trashëgimtarja nuk duhet të qante. Nina hapi sërish sytë.

- Jam shumë mirë, - mërmëriti. - Kur ta shihni Kristinën, a mund t'i bëjë dikush me shenjë? Do të doja një kafe tjetër.

Nina u kthye, por ajo nuk po kërkonte Kristinën. Sytë e saj ishin te dera, duke pritur të atin të vinte në tavolinë. Zemra e saj nuk ishte e pathyeshme. Dhe kjo ishte e vërtetë...

Pas *brunch*-it, Timi i sugjeroi të bënë diçka argëtuese, por Nina nuk dukej e interesuar.

- Më vjen keq! - i tha teksa qëndronte jashtë hotelit. - Ti mund të argëtohesh, nëse dëshiron. Unë... po shkoj në shtëpi dhe... nuk e di. Do të lexoj ndonjë libër ose do të bëj diçka tjetër, derisa të vijë ora për t'u bërë gati për ekspozitën e artit në mbrëmje. Tani sikur nuk jam në humor.

- Dua të të ndihmoj, - pëshpëriti ai, duke e vërtitur gishtin rreth flokëve të saj e më pas përgjatë shpinës.

- Vetëm më thuaj çfarë të bëj!

Por e vërteta ishte, se ajo nuk e dinte. I shtrëngoi dorën, duke vështruar pemët matanë rrugës, lulet në lulëzim të plotë, karrocet me dy kuaj që prisnin për pasagjerë. Dukej disi më e qetë tani, që ishte këtu me Timin, teksa ndiente gishtat e tij të gërshetuar me të sajat.

- Eja të shkojmë në park! - mërmëriti Nina.

Pasi ecën në pjesën jugore të *Central Park*-ut, duke shijuar rrezet e diellit, kaluan përmes Portës së Artistëve. Kur morën kthesën, një flad ia valëviti fundin.

- Më vjen keq që jam kaq e mërzhitur. Më duket sikur... një lloj errësire qëndron e varur mbi çdo gjë.

- Edhe kur je me mua? - e pyeti Timi.

Nina psherëtiu. Kur dëgjoi trokëllimën e thundrave prapa tyre, u kthye dhe pa një kalë të përhirtë, që po ecte në rruginë, duke tërhequr një karrocë të bardhë me një familje brenda. Kjo nuk kishte të bënte me marrëdhënien e tyre. Shpresonte që Timi mos ta keqkuptonte.

- Gjithmonë, - pëshpëriti ajo.

Ai u gëlltit dhe fytyra i mori atë shprehjen e djallëzuar, që ajo e njihte mirë.

- Asgjë nuk do të të gëzonte? - e pyeti. - As edhe një xhiro në karusel?

Goja e Ninës mezi nxori një buzëqeshje. Ajo e kishte hipur me zor Timin në karuselin e *Central Park*-ut, aq shumë herë sa nuk mund të numëroheshin. Por tani tundi kokën.

- Në të vërtetë, nuk dua të më bësh të qesh, - vërejti.
- Unë, thjesht... a mund të qëndrosh në errësirë me mua? - Javët e fundit, ajo e kishte rijetuar shumë herë në mendje udhëtimin me Rafaelin në makinën e tij, duke u përpjekur të kuptonte pse e kishte bërë atë të ndihej më mirë. Dhe kjo kishte qenë arsyeja: ai kishte qëndruar me të në errësirë dhe ajo ishte ndier e sigurt. Pikërisht për këtë kishte pasur nevojë atëherë. Dhe për këtë kishte nevojë edhe tani...

- Të kujtohet kur vajtëm për ski në *Park City*? - e pyeti Timi kur po ecnin, teksa biçikletat dhe vrapuesit kalonin pranë tyre.

Nina pohoi me kokë. E dinte se çfarë do të thoshte ai. Kishte qenë njëmbëdhjetë vjeçe atëherë dhe ishte tmerruar.

- Nuk mund të shihnim as një metër përpara nesh.

Ajo pohoi sërish me kokë. Atë e kishte kapur paniku. Edhe Timin.

- Edhe pse ishim të trembur dhe nuk e dinim ç' do të ndodhte më pas, ne ecëm ngadalë, qëndruam së bashku dhe arritëm të zbrisnim në fund të pistës, - tha Timi.

Nina e vështroi.

- Do të zbresim nga ky mal, Nina, - i pëshpëriti. - Por nuk ia vlen të shqetësohesh për mënyrën se si... Babai yt është mirë tani. Do të përballojmë gjithçka, kur të vijë momenti. Tani, për hir të kohërave të vjetra, po sikur ta provojmë, nëse një xhiro në karusel do të të bënte të buzëqeshje? Do ta bësh një përpjekje? Për mua?

Ajo psherëtiu thellë.

- Për ty, - mërmëriti.

Ai e çoi në qendër të parkut, ku dielli shkëlqente.

- Dua vetëm që ti të jesh e lumtur, - vërejti Timi. Pastaj u përkul dhe e puthi. Dhe ajo u përpoq të harronte gjithçka, të humbiste në puthjen e tij, si kishte bërë para katër muajve, herën e parë kur i kishte ndier buzët e tij mbi të sajat. Por nuk mundi...

Në shkollën e mesme *Brearley*, të gjitha shoqet e Ninës donin të dinin se çfarë po ndodhte, kur Timi e shoqëroi në mbrëmjen e vallëzimit të tetë shkollave të mesme të Nju-Jorkut. Ajo ishte në vitin e dytë, ndërsa ai në të fundit. Dy vite më vonë, ato ishin të sigurt se kishte diçka mes tyre, kur ai erdhi nga *Stenford*-i për ta takuar në fundjavë. Por asgjë nuk po ndodhte atëherë. Të paktën, kështu mendonte Nina. Timi ishte personi tek i cili ishte mbështetur gjithmonë, tek i cili kishte pasur besim dhe e kishte respektuar. Por ai nuk ishte personi, që ajo kishte ëndërruar ta puthte.

Prisi e kishte pyetur përsëri ç'po ndodhte midis tyre, kur Timi vizitoi Ninën në universitet, duke udhëtuar nga njëra anë e Amerikës në tjetrën, për të kaluar fundjavën me të në New Haven. Por Nina, edhe atëherë e konsideronte si shok. Ishte ai, të cilit i telefononte, kur e merrte malli për Nju-Jorkun. Ishte ai që ia ngrinte humorin. Por Timi nuk ishte personi, emrin e të cilit e shkarraviste në bllokun e spanjishtes, personi që e bënte të ndihej gjuhëlidhur, kur e ndeshte në mensë.

Më vonë, në janar, Timi ia kishte vendosur dorën rreth belit, kur babai i saj njoftoi mediet, se i ishte kthyer kanceri dhe përfundimisht do të tërhiqej nga posti i kryetarit të bordit. Teksa i ati thoshte këto fjalë, Timi e shtrëngonte Ninën pranë vetes.

“Kush do t’ju zëvendësojë si kryetar i bordit?”, kishte pyetur një reporter.

“Do ta mbaj këtë post për aq kohë sa do të kem mundësi të punoj”, ishte përgjigjur ai. “Më pas do të më zëvendësojë vajza, ashtu si unë, babanë tim. Ky është ende një biznes i familjes.”

Nina kishte marrë frymë thellë. Kjo ishte e vërtetë. Kjo do të ndodhte. Para se të fillonte shkollën e biznesit, ajo kishte bërë një marrëveshje me të atin: do të punonte në politikë, derisa ai t’i kërkonte të merrte drejtimin e korporatës. Ajo kishte menduar se do të ishte gati deri atëherë. Do të ishte në gjendje të vazhdonte trashëgiminë e familjes, pasi të kishte fuqizuar të vetën. Por ajo nuk pati as dhjetë vjet kohë; do të humbiste jo vetëm babanë, por edhe jetën që kishte imagjinuar për veten. Të ardhmen që kishte shpresuar, se do të ishte e saja.

“Mirë je?”, i kishte pëshpëritur Timi në vesh gjatë konferencës për shtyp.

Nëse do të kishte qenë dikush tjetër, ajo do të kishte thënë “po”. Por Timit iu përgjigj çiltërsisht: “Jo”.

Kjo nuk ishte thjesht një kompani. Këtu nuk bëhej fjalë thjesht për një hotel. Këtu bëhej fjalë për

familjen e saj, për babanë, gjyshin, për çdo gjë që ata sakrifkuan, për çdo kompromis që bënë, për çdo gjë që rrezikuan për të fuqizuar vendin e tyre në shoqërinë e Nju-Jorkut.

“Atëherë, eja të ikim që këtej”, i kishte thënë Timi. Kishte nxjerrë telefonin nga xhepi, duke u shtirur sikur dikush po e telefononte. E kishte vënë te veshi dhe kishte rrudhur vetullat. Pastaj kishte prekur lehtë Ninën te supi dhe ende duke u hequr sikur dikush ishte në linjë, i kishte bërë me shenjë të shkonte me të.

Ata kishin ulur kokat dhe ishin futur në një sallë konferencash, ku nuk kishte njeri.

“Ishte e neveritshme”, i kishte thënë ai.

“Ishte edhe më keq se kaq”, ishte përgjigjur Nina. “Një mijë veta duke të vëzhguar, teksa gjendeshe në një siklet të tillë”.

Timi kishte ngritur vetullat, i çuditur që po e dëgjonte të fliste në këtë mënyrë.

“Pra bëra mirë që të nxora që andej.”

Nina nuk e kishte mbajtur dot të qeshurën. Ajo ishte e gëzuar që Timi ishte me të. E gëzuar që organizoi “arratisjen” e tyre nga salla.

- Babai më tha që do të shkojmë për darkë në shtëpinë e babait tënd sonte. - Ai vajti te banaku dhe bëri nga një kafe ekspres për secilin.

- Po, - u përgjigj Nina. - Më tha që dëshiron të jetë i rrethuar nga njerëzit që do më shumë.

Timi u ul dhe ia vuri përpara filxhanin.

- Më fal që po të pyes. Ti do të gatuash?

- Me Irenën, - shpjegoi Nina. - Të mbetet mes nesh, sonte do të gatuajmë ushqimet e preferuara të babait.

- Pra, biftek japonez “Kobe”? - Ai i dha trupit prapa në karrige, duke ngritur dy këmbët e përparme nga toka. “Duket shumë i qetë”, mendoi Nina. “Shumë i rehatuar”. Timi kishte qenë gjithnjë kështu. Ndihej shumë mirë me veten. Ajo e admironte këtë. Nganjëherë pyeste veten, si do të ishte sikur të ndihej edhe ajo ashtu, të mos kujdesej për fjalët që thoshte, të mos kontrollonte emocionet, të mos i vlerësonte veprimet e veta sipas pritshmërisë së babait. Pyeste veten si do të kishte qenë, nëse nuk do të ishte rritur në këtë mënyrë: kaq e disiplinuar, kaq e vëmendshme.

- Mm-hm, - iu përgjigj Nina. - Edhe byrek me vezë të rrahura dhe limon, bishtaja me bajame dhe bukë misri me mjaltë.

- Sa të shijshme janë! - ia ktheu Timi, duke e anuar karrigen sërish përpara. - Mezi po pres.

Pas darkës, Timi e shoqëroi Ninën dhe ata pinë nga një koktej në barin “Weather Up”, shumë afër apartamentit të saj, pastaj edhe nga një tjetër. Më vonë vajtën të uleshin pranë lumit. Filluan të flisnin për jetën, dashurinë dhe të ardhmen, teksa fryma e tyre lëshonte shtëllunga tymi në ajrin e ftohtë të mbrëmjes. Pastaj Nina filloi të qante dhe ai e shtrëngoi pas vetes.

Ndoshta ishte alkooli, ose ndoshta ishte pikërisht çasti kur kjo ishte e thënë të ndodhte, por Timi e puthi dhe ajo u qetësua në krahët e tij. Ai kishte shijen e së shkuarës, së tashmes dhe së ardhmes njëherësh.

Kur Prisila telefonoi për të pyetur se çfarë nënkuptonin fotografitë nga konferenca për shtyp, Nina dhe Timi, më në fund, kishin filluar të dilnin bashkë. “Ju të dy jeni bërë për njëri-tjetrin”, i kishte thënë ajo. Dhe ndoshta kjo ishte e vërtetë...

Qëkur Xhozef Gregorit iu rikthye sëmundja, Kero e telefononte Ninën më shpesh.

- Ç'kemi, zemër? - Ishte pasdite vonë e së dielës, në fundjavën pas *brunch*-it. - Jam këtu në hotelin "Seaport", duke u marrë me disa çështje të furnizimit me ushqime.

- Ka ndonjë gjë që nuk shkon? - pyeti Nina. Ishte në dhomën e saj të ndenjjes, duke lexuar me zë të lartë një fjalim, që sapo e kishte shkruar. Ajo e ulte zërin për të kuptuar si do të tingëllonin fjalët kur t'i lexonte Rafaeli.

- Çdo gjë në rregull, - shpjegoi Kero. - Por meqenëse jam afër shtëpisë sate, si thua bëjmë një shëtitje përgjatë lumit?

Nina ishte një nga ata pak njerëz në jetën e Keros, që nuk e kishte problem të bënte shëtitje të gjata me të. Kero i planifikonte ato në agjendën e saj, ndërsa Tixhei i konsideronte si shpërdorim kohe.

Nina e lëshoi nga dora fjalimin që po lexonte.

- Sigurisht, - u përgjigj, e gëzuar për këtë pushim.
- Shihemi pas pak.

Ato e lanë të takoheshin në hollin e hotelit “The Gregory by the Sea”. Menjëherë pas vdekjes së gjyshit të saj, kur Nina ishte dy vjeçe, i ati kishte hapur hotelin e dytë pranë portit dhe barin në katin e fundit e kishte quajtur “Foleja e Ninës”. Prej andej, mund të shikoje tërë portin e Nju-Jorkut. Ishte një nga pamjet e preferuara të qytetit për Ninën.

Kur Nina mbërriti te hoteli, u përshëndet me stafin dhe pastaj qëndroi përpara derës së ashensorit, në anë të së cilës ishte varur korniza me artikullin e revistës “People” për prindërit e saj. Në njërën nga fotografitë, ata të dy po qeshnin. E ëma i kishte lëshuar flokët e zinj, që i binin në fytyrë. Nina pyeste veten, nëse ajo ishte dukur po kaq e bukur, kur i tërhoqi vëmendjen të atit në Barcelonë. Ai po shijonte *paella* dhe një gotë verë në plazh, ndërsa mamaja e Ninës po përfundonte tezën e doktoraturës mbi përshkrimin e trupit femëror në letërsinë spanjolle. Ai gjithnjë kishte thënë se ajo dukej shumë e bukur, teksa lexonte në plazh. Dukej aq e qetë dhe e brishtë, saqë ai mendoi se duhet ta ftonte në tavolinë.

Media e pëlqeu shumë historinë: beqari më i dëshirueshëm i Nju-Jorkut bie në dashuri me një vajzë të panjohur nga Kolorado, ndërsa ndodhet me pushime. Dasma e tyre u bë në sallën e vallëzimit, në katin e tridhjetedytë të hotelit “The Gregory on the Park” dhe për të shkruan: “The New York Times”, “The New York Post”, “Newsday”, “New York

Magazine”, dhe “The Daily News”. Madje pati artikuj të shkurtuar edhe në revistat kombëtare. Artikujt u vendosën nëpër korniza dhe u shpërndanë në të dyja hotelet. Nina kishte vizatuar dikur një hartë, ku jepej me hollësi vendi ku ishte varur secila prej tyre. Ajo e kishte quajtur “harta e thesarit”, që në fakt, ishte historia e dashurisë së prindërve të saj.

Nina kujtonte kur e kishte parë për herë të parë artikullin prej dy faqesh, në revistën “People”. Ishte pesë vjeçe dhe shkrimi ishte botuar si pjesë e reportazhit për hapjen e barit, në katin e fundit të hotelit “The Gregory on the Park”. Babai i saj ia kishte vënë emrin barit “Los Tortolitos”, që në spanjisht do të thoshte “Të dashuruarit”. Kështu ishin quajtur prindërit e saj nga shtypi spanjoll dhe ai e adoptoi si me shaka për ata të dy. Nina i kishte kërkuar së ëmës t’ia lexonte titullin e artikullit. “Los Tortolitos: Një histori dashurie”, kishte lexuar ajo, kur Nina i kishte sjellë revistën. Dhe, më poshtë thuhet: *Nuk do të dëshironit që mashkulli juaj t’ju vështronte, ashtu siç e vështron Xhozef Gregori, Fabin?*

“Unë do të dëshiroja, mama.”

E ëma kishte qeshur dhe e kishte marrë në krahë. “Kur të rritesh, do të gjesh dikë që do të të dojë kështu, por jo për një kohë të gjatë”. Nina pyeste veten, nëse Timi e vështronte ashtu tani.

- Nina, zemër, - thirri Kero nga holli, duke e shkundur Ninën, që kishte humbur në ëndërrime. Kero kishte veshur pantallona të bardha, të qepura me porosi, një pulovër të hapur deri te supet dhe një palë këpucë të sheshta. Kishte vënë një shall mëndafshi rreth qafës. Veshja e saj ishte joformale, meqenëse ishte e diel. Por veshja joformale e saj, ishte, në të vërtetë, formale për shumë njerëz.

- Prindërit e mi dukeshin shumë të lumtur së bashku, - i tha Nina Keros, kur filluan të ecnin përgjatë lumit, me mendjen ende tek artikulli i revistës.

- Ata plotësonin mjaft mirë njëri-tjetrin.

Jahtet po parkoheshin në portin e Nju-Jorkut dhe Kero u ndal të shikonte njërin prej tyre që po hidhte spirancën.

Ishte e çuditshme... Kur Nina dilte me meshkuj të tjerë, ajo fliste me Keron për ta. I bënte pyetje, donte të dinte mendimin e saj, jo domosdoshmërisht për meshkujt, por për atë që duhet të thoshte, për atë që ndiente, apo si t'i menaxhonte emocionet e tyre dhe të babait të saj. Por tani që dilte me djalin e Keros, e kishte të vështirë të fliste me të. Të paktën, jo drejtpërdrejt.

- Cila mendon se është gjëja më e rëndësishme, që e bën marrëdhënien tënde me xhaxhi Tixhein të funksionojë kaq mirë? - e pyeti Nina.

Sirena e një anijeje u dëgjua nga larg dhe Kero u kthye nga Nina.

- Singëriteti, - vërejtji. - Gjithmonë i kam thënë Tixheit që nëse jemi të singërtë me njëri-tjetrin mund të përballojmë gjithçka që na del përpara. Madje mund të jemi edhe partnerë. Një skuadër. Të përballemi me botën si një front i bashkuar. Unë e di që gjithnjë mund të kem besim tek ai.

Nina pohoi me kokë. Ajo pyeste veten, nëse Timi ndihej kështu... Që mund të kishte besim tek ajo për gjithçka. Pa dyshim, kjo kishte qenë e vërtetë. Ai kishte ndarë me të sukseset, dështimet me të dashurat, madje edhe gjërat më sekrete, si gabimi që kishte bërë në punë vitin e kaluar, që i kushtoi kompanisë së tij një investitor. Mezi kishte mundur t'ia thoshte. Edhe ajo e dinte që i kishte treguar atij gjithçka: për punët e saj, ish-të dashurit, sikletet dhe shqetësimet. Por befasi u kujtua, që nuk i kishte treguar për bisedën me Rafaelin në makinë, para pritjes për mbledhjen e fondeve.

Donte ta pyeste Keron, nëse kjo përbente problem, por ndërroi mendje.

- Kur filluat të takoheshit me xhaxhi Tixhein, ishte... emocionuese? A... të rrihte zemra fort, kur të prekte supin?

Kero qeshi.

- Edhe kur e shihja të ecte në rrugë, më rrihte zemra, - u përgjigj ajo. - Jam e kënaqur, që edhe ti dhe Timi ndiheni kështu.

- Po, - mërmëriti Nina. Kero e përkuli paksa kokën, sikur të kishte nevojë ta shikonte shprehjen në fytyrën e saj, por nga tjetër kënd.

- Jeni të lumtur ju të dy? - e pyeti.

- Po, jemi, - ia ktheu Nina, teksa u larguan nga skela dhe filluan të ecnin. - Më thuaj, ç'u bë sot me furnizuesit e ushqimeve?

Do të kishte dashur t'ia hapte zemrën Keros, por tani, kjo dukej e pamundur. Nina do të kishte dashur, ndoshta për të njëmiliontën herë në jetën e saj, që e ëma të ishte gjallë. Por, edhe kjo ishte e pamundur...

8

Kur Nina u kthye në lagjen *Traibeka*, vendosi çelësin tek ashensori për t'u ngjitur në baxhën e saj dhe i telefonoi Leslit. Kishte nevojë për një dozë qetësuese nga shoqja e saj e ngushtë. Vetëm kur ia dëgjonte zërin Leslit, Nina ndihej më e fortë, më e aftë për të përballuar atë çka e kishte çoroditur disi.

- Les! - mërmëriti, kur shoqja e saj u përgjigj në *facetime*. - Ku je?

- Në ndeshjen e futbollit të Kolit, - iu përgjigj Lesli, duke e rrotulluar celularin, që Nina të shikonte fushën. - Pse i detyrojmë katërvjeçarët të luajnë futboll? Gjysma e tyre nuk e gjuajnë dot topin, as kur e kanë një pëllëmbë përpara vetes.

Nina picërroi sytë dhe pa Kolin me flokët e zinj kaçurrelë që i tundeshin, teksa vraponte.

- Të paktën duket sikur po kënaqet, - vërejti ajo.

- Ai vetëm vrapon nga njëra anë e fushës në tjetrën, - vazhdoi Lesli. - Dhe ne paguajmë për këtë. Ndërkohë që në oborrin prapa shtëpisë, mund të vrapojë pa pagesë.

Nina qeshi.

- Mos duhet të kthehesh te ndeshja?

- Aspak. - Nina pa Leslin të ngrihej. Ajo i tha Vixheit që do të kthehej shpejt dhe zbriti nja dy shkallë. - Sa mirë që më dhe një justifikim për t'u ngritur! - tha ajo sapo u afrua pranë disa pemëve. - Këta stolat duhet të kishin ca jastëkë për t'u ulur. Si po shkojnë gjërat? Fushata? Babai yt? Timi?

- Gjithçka po shkon... - Nina po qëndronte pranë vetratës në dhomën e saj të ndenjjes, duke vështuar rrugët e kalldrëmta të lagjes *Traibeka*. - Sapo u ktheva nga një shëtitje me Keron. Më mungon shumë mamaja ime, Les.

- Oh, Nin, - Lesli u ul mbi bar dhe u mbështet në trungun e një peme. - Është një ndjesi që të pushton vazhdimisht... - Mamaja e Leslit kishte vdekur, kur ajo dhe Nina ishin në universitet. Ajo besonte se Lesli ishte një nga ata pak persona, që vërtet mund të qëndronte me të në errësirë. Megjithatë, edhe momenti i keqardhjes së Rafaelit e kishte habitur.

- Ajo ka vdekur pothuaj njëzet e pesë vjet më parë, - mërmëriti Nina, duke dëshiruar të ishte atje, pranë shoqes së saj, e mbështetur në pemën ngjitur. - Kisha menduar se do të vinte një moment, që do ta ndieja më pak mungesën e saj. Por nuk mendoj se kjo do të ndodhë ndonjëherë...

Ninës i kujtohej kur - ishte shumë e vogël - shkonte me mamanë e saj në Universitetin e Kolombias. Ajo ulej në një zyrë të vogël, të mbushur me libra

dhe studentët e së ëmës e pyesnin sa vjeç ishte, apo cila ishte ngjyra e saj e preferuar. Mamaja e nxiste të përgjigjej “en español”, pasi ishte përgjigjur në anglisht.

“Ka mollëzat e tua”, thoshin profesorët e tjerë.

Ose: “I ka qukat si ti”.

Ishte e vërtetë. Këto dy tipare të fytyrës Nina i kishte njësor si e ëma, por gjithçka tjetër e kishte si i ati. Flokët i kishte ngjyrëkafë të çelur dhe të mëndafshtë, ashtu siç i kishte pasur ai. Sytë e saj ishin ngjyrë blu e errët si të tjtë. Të dy kishin gropëza në faqe, ndërsa hundën e kishin me majë përpjetë. Sa herë që njerëzit i shikonin së bashku për herë të parë, sytë e tyre do të zhvendoseshin nga njëri tek tjetri, për të parë ku ndryshonin tiparet e tyre të përbashkëta.

Ndonjëherë, Nina pyeste veten, nëse do t’i ngjante më tepër mamasë, po t’i mbante flokët më të shkurtër. Por ngjyra e flokëve të saj ishte shumë më e çelët... Dikush në familjen e së ëmës, duhet të kishte gjithashtu flokë me ngjyrë të çelët, ndonëse Nina nuk e dinte kush ishte. Ajo nuk kishte albume nga fëmijëria e mamasë së saj, ashtu si kishte nga i ati. Hallat dhe xhaxhallarët e babait apo kushërinj të largët, që ende jetonin kryesisht në Angli dhe Uells, vinin nëpër festat e ndryshme që organizonte i ati.

- As unë nuk mendoj se do të ndodhë, - u përgjigj Lesli, duke e rikthyer Ninën në bisedë. - Por ndoshta kjo është diçka e mirë. Nëse të merr malli për të, do të thotë që ti e kujton. Do të thotë që ajo është ende këtu.

- Them se po, - mërmëriti Nina. - Por a i lehtëson kjo gjërat?

Lesli pushoi për një çast.

- Nuk thashë që është e lehtë. - Nina pa shoqen e saj të ngrihej befas. - Oh, nuk mund ta besoj! Im bir sapo shënoi një gol. Të lumtë, Kol!

Nina buzëqeshi. Në sfond dëgjonte të gjithë prindërit e tjerë, që duartrokisnin.

- Duhet të shkosh! Uroje nga unë!

- Patjetër, - ia ktheu Lesli. - Do të të telefonoj më vonë. Të dua, zemër! Më ka marrë malli.

- Edhe mua.

Nina rrëmbeu çantën dhe vendosi të dilte për të ngrënë një kos të ftohtë me spërka shumëngjyrëshe. Ishte diçka që e kishte bërë me të ëmën. Ndoshta kjo ishte një pasdite për të kujtuar...

9

Javën që pasoi dukej si verë. Qershori kishte ardhur. Ishte mjaftueshëm ngrohtë, që gratë për herë të parë të dilnin jashtë me fustanet pa mëngë, që nga shtatori i kaluar. Dielli ndriçonte, qielli kishte një ngjyrë blu të thellë dhe puhia e lehtë që frynte sikur e gjallëronte ditën. Zakonisht, Nina pinte kafënë që Xheini përgatiste në zyrat qendrore të fushatës, por rrugës për në punë vendosi të ndalonte për një kafe të ftohtë.

Ajo u ndal te vizat e bardha, teksa makinat ecnin përpara saj. E ngriti fytyrën nga dielli dhe mbylli sytë për një çast, për të dëgjuar boritë, motorët e makinave dhe bisedat e zhurmshme, që i jepnin Nju-Jorkut energjinë dhe gjallërinë e tij.

Ditët e fushatës po bëheshin më të gjata dhe ajo e dinte që kafeina do ta ndihmonte t'i kryente detyrat e saj, të paktën për disa orë. E humbur në mendime, u përplas me personin që po dilte nga kafeneja. Ata ndaluan që të dy, të shastisur për një çast nga përplasja. Pastaj Nina ngriti sytë. Ishte Rafaeli.

- E çuditshme të takosh një vajzë si ti, në një vend si ky, - vërejt, duke e vendosur dorën në krahun e saj, për ta qetësuar atë dhe veten.

- Ne të varurit nga kafeina duhet t'i qëndrojmë pranë njëri-tjetrit, - ia ktheu ajo. Ata nuk ishin prekur, që ditën kur vajtën me makinën e tij në klubin "Norud", rreth një muaj më parë dhe dora që ai i vuri mbi krah, bëri që befas asaj t'i skuqeshin faqet.

- Ashtu qoftë, - u përgjigj ai. U shkëput prej Ninës dhe ngriti gotën prej letre për një doll. - Këtu ka tri masa ekspresi. Hej, sapo mora vesh që ata Lenserat, me të cilët më njohe ti, po planifikojnë një darkë për të mbledhur fonde për mua. Kristi do ta shtojë në agjendën time. A ka ndonjë mundësi që të të bind të vish? Ti je shumë e zonja për këtë punë. I bën prezantimet të duken të natyrshme.

- Sigurisht. Me kënaqësi. Është caktuar data?

- Nuk besoj. Por do t'i them Kristit të të njoftojë, sapo ta marrë vesh.

Nina pohoi me kokë.

- Në rregull, - mërmëriti.

Rafaeli e mbajti dorën pezull mbi supin e saj, pastaj e lëshoi pranë vetes.

- Mirë, atëherë. Të falënderoj. Do t'ia kalojmë mirë. - Ai i buzëqeshi. Ishte buzëqeshja e tij e vërtetë...

Kur Rafaeli doli dhe Nina u fut në radhë, asaj nuk i hiqej nga mendja reagimi i trupit të saj, kur gishtat e tij e prekën në krah. Po atij i kishte rrahur zemra fort,

kur e kishte prekur? Ishte kjo arsyeja që pothuajse ia vuri dorën mbi sup? Ishte kjo arsyeja që kishte vendosur të mos e bënte?

Nina nxori telefonin nga çanta. “Thjesht doja të të përshëndesja”, i shkroi Timit. “Shpresoj të jesh kënaqur në ndeshjen e mbrëmshme.”

Ajo duhet të ishte e kujdesshme.

Darka e Lenserave ishte në të njëjtën mbrëmje, kur organizohej edhe eventi në universitetin *Smith* për profesoreshën që do të dilte në pension.

- Nuk e kuptoj pse je kaq e acaruar për këtë, - vërejtí Timi të nesërmen në mëngjes, kur ai dhe Nina po bëheshin gati për të shkuar në punë. Ai ishte në lavamanin e saj, i mbështjellë me një peshqir, nga mesi e poshtë. Nina pa t'i fryheshin muskujt e kraharorit, ndërsa rrëshqiste makinën e rrojës nëpër mjekrën e tij katrore. - Ty sikur nuk të pëlqen aq shumë Megi Lenseri.

Por nuk ishte kjo arsyeja. Ishte fakti që kjo nuk ishte zgjedhja e saj.

- Thjesht... Më vjen inat që nuk munda të them "jo", - i shpjegoi Nina, teksa mbërtheu perlat e gjyshes në qafë, që i kishte trashëguar në ditën e saj të lindjes.
- Mos po tregohem e pacipë?

Timi e fiku makinën e rrojës dhe ngriti lehtë supet e tij me quka.

- Këtu bëhet fjalë për një kompromis, - u përgjigj ai. - Paratë vijnë me kushte. Ky është një nga kushtet

e tua. Po sikur... të bëjmë, nuk e di, tre ose katër, ose edhe pesë fëmijë dhe t'u kërkojmë atyre t'i mbajnë këto fjalime për ty. Ose... mund t'i mbaj edhe unë, nëse ti nuk dëshiron ta bësh.

Nina ngriti sytë për të parë buzëqeshjen e zakonshme në fytyrën e Timit. Ajo imagjinoi fëmijë të vegjël, me flokët e tij të kuq dhe sytë e saj blu. Ajo nuk do t'i detyronte kurrë ata të kryenin angazhime të tilla.

- Fëmijët tanë do ta zgjedhin vetë atë që dëshirojnë të bëjnë, - nga toni i zërit ajo që tha tingëlloi më serioze sesa synonte. Pastaj largoi flokët nga shpina dhe u kthye.

- Do të ma mbërthesh pak zinxhirin?

Timi u tregua i gatshëm.

- Nuk bëhet fjalë për kushte këtu, - vazhdoi të fliste Nina. - Unë do ta mbaj këtë fjalim, sepse ma kërkoi babai, por herën tjetër, ndoshta mund t'i dërgoj diçka dikujt tjetër, që ta lexojë.

Timi kishte hyrë në dhomën e gjumit dhe po mbërthente kopsat e këmishës së tij të bardhë; xhinset dhe xhaketa e tij sportive ishin vendosur mbi shtrat.

- Jam i sigurt që mund ta bësh, - u përgjigj ai. - Por nuk është ndonjë gjë aq e tmerrshme të të kërkohet të mbash një fjalim, sepse familja jote ka sponsorizuar një profesoreshë.

Nina e vështroi Timin sërish. Ajo e dinte që ishte jashtëzakonisht me fat, në kaq shumë mënyra.

Ajo gjithnjë ishte përpjekur të mos harronte, që miliona njerëz do t'i shkëmbejnë në çast vendet me të. Megjithatë, në atë moment, ajo dëshironte t'i shkëmbente vendet me Timin. Që ai të merrte drejtimin e korporatës “Gregori” dhe ajo të ishte fëmija e Keros dhe Tixheit, nga e cila nuk pritej asgjë, përveç suksesit në fushën që kishte zgjedhur vetë. Por nuk funksiononte kështu. Ajo ishte një Gregori. Dhe kjo do të thoshte, që kishte disa përgjegjësi që ishin të sajat... vetëm të sajat...

Mbrëmjen e së hënës që pasoi, Nina u nis për në shtëpinë e të atit. Ata do të hanin darkë, duke parë shfaqjen e tyre të përjavshme televizive *Jeopardy*. Ashtu si Timi, Xhozef Gregori ishte një produkt i zakonit dhe, veçanërisht, pasi i vdiq e ëma, Nina gjeti ngushëllim në faktin, se tani mund t'i parashikonte gjërat. Qëkur ishte fëmijë, ata hanin ushqim kinez së bashku, të paktën një të hënë të çdo muaji. Kur po ecte në drejtim të restorantit kinez, përshëndeti Janishën, e cila kishte punuar në farmaci në sheshin *Columbus*, qëkur Nina kishte qenë në shkollë të mesme. Ia bëri me dorë te dritarja Penit, që punonte si recepcioniste në lokalin e vogël matanë rrugës, qëkur Nina kishte qenë në shkollën tetëvjeçare. Vizitorët shpesh e kritikonin qytetin e Nju-Jorkut, se duke qenë i tejmbushur me njerëz, nuk të krijonte mundësi për lidhje të qëndrueshme. Por Nina, në të vërtetë, kishte konstatuar të kundërtën. Blloqet e shtëpive përreth apartamentit të babait të saj, dukeshin si një fshat i vogël. Piceria, tezga e frutave, pastrimi kimik,

butiku i veshjeve. Nina mendoi, jo për të parën herë, se qyteti i Nju-Jorkut përbëhej nga qindra botë të ndryshme, secila ngjitur me tjetrën. Të shkonte në një farmaci pesë blloqe pallatesh më tutje, ishte njësoj si të shkonte në një farmaci në Nju-Xhersi. Pasi mori çantat me ushqim kinez, ajo u drejtua për tek apartamenti i të atit.

Para disa muajsh, prindërit e Prislës ishin larguar nga apartamenti, ku Prisi ishte rritur dhe për këtë ajo ishte dëshpëruar më shumë sesa kishte menduar Nina. “Atje është e gjithë fëmijëria ime”, vazhdonte t’i thoshte. “Tashmë ajo është fshirë.”

“Nuk është fshirë”, e kishte qetësuar Nina. “Kujtimet e tua janë aty, pavarësisht ku jetojnë prindërit e tu.”

Por që atëherë, Nina u lidh jashtëzakonisht shumë me këtë ndërtesë, ku ajo mësoi të ecte dhe të fliste, ku jetoi me njerëzit që e panë të rritej. Në *Manhatan*, një ndërtesë e tillë ishte një komunitet, një qytet i vogël brenda një qyteti të madh. Dhe të gjithë këtu, punonjës dhe banorë, kishin luajtur rolin e tyre për ta bërë Ninën personin që ishte tani.

Kur u ngjit në apartamentin 21-B, hyri në holl dhe thirri të atin:

- Baba! Erdha unë. Ku je?

- Në dhomën e ngrënies, - u përgjigj ai. Zëri i tij iu duk më i mekur sesa zakonisht. Dhe fjalët u ndërprejnë nga një e kollitur. Vetëm një e kollitur...

Nina eci nëpër dhomën e madhe, e cila ishte ndarë në pjesë të ndryshme me sixhade dhe mobilie; njëra sipërfaqe kishte divane, tjetra kishte një tryezë dhe karrige, ndërsa një tjetër kishte një bibliotekë dhe një kolltuk dysh. Nëpër mure ishin varur piktura nga koleksioni i gjyshes së saj.

Pas dhomës së madhe, vinte kuzhina dhe pastaj dhoma e ngrënies. Punëtorja e tyre, Irena, e kishte shtruar tavolinën me enët e porcelanit me shirit ari, që kishin qenë të gjyshes. Ajo kishte vendosur një vazo plot me luledele në mes të tavolinës. Gjashtë muaj pasi Irena kishte filluar të punonte për Gregorit, kur Nina ishte në klasën e gjashtë, ajo i kishte treguar një histori për dy djemtë e saj, që ishin gjithashtu në ciklin e ulët të shkollës së mesme, në *Brighton Beach*. Nina kishte kuptuar, se kur Irena ishte në punë, ajo nuk qëndronte me fëmijët e saj. Më pas, filloi t'i thoshte asaj që do të hante darkë me shoqet pas shkollës, në mënyrë që Irena të shkonte më herët në shtëpi. Ndonjëherë, Nina, në të vërtetë, shkonte në shtëpinë e Prisolës, në pjesën verilindore të qytetit të Nju-Jorkut, ose në shtëpinë e Timit, që jetonte disa ndërtesa më tutje. Por ndonjëherë, ajo e kalonte pasditen në Muzeun Metropolitan të Artit (Met), duke bërë detyrat në Tempullin *Dendur*. Më pas hante darkë herët, në sallën e ngrënies së anëtarëve të bordit, në katin e katërt. Ata zakonisht nuk shërbenin darkë gjatë ditëve të javës, por shefi i kuzhinës bënte një përjashtim për të. Dhe ky ishte sekret i tyre...

- Mendon që Uilli do të fitojë sërish? - e pyeti i ati, teksa ndezi televizorin, që e kishte vendosur aty posaçërisht për darkat e të hënave. Ai kishte folur për Uillin gjatë gjithë javës së kaluar. Për baristin nga Teksasi, kjo kishte qenë një periudhë fituese. - Vë bast me një sheqerkë, që ai fiton.

Nina nxori ushqimin nga kutitë dhe e zbrazti me lugë tek enët që Irena kishte vendosur mbi tryezë. Ata kishin vënë baste me sheqerka për rezultatet e lojës, qëkur kishin filluar ta shihnin atë së bashku.

- Nuk e di, - u përgjigj Nina. - Shumica e kampionëve nuk arrijnë as te dita e katërt. Gjasat që ai të luajë në ditën e pestë, janë të pakta. Po sikur të vëmë bast me një çokollatë *Hershey* që ai nuk do të luajë?

Babai i Ninës qeshi.

- Po i shmangesh riskut, e kuptoj. Nuk po e merr në konsideratë parimin e Ken Xheningsit, që disa njerëz janë thjesht më të zgjuar dhe mund të jenë fitues për njëfarë kohe.

Nina i vendosi kutitë e boshatisura prej kartoni në çantën me të cilën i kishte sjellë dhe e hodhi në koshin e plehrave të kuzhinës.

- Ken Xheningsi është një në një milion, - vërejti ajo.

- Ndoshta i tillë është edhe Uilli, - u përgjigj i ati, duke marrë lugën e supës.

Aleks Tribeku u shfaq në ekran. Nina dhe babai i saj hanin dhe shikonin shfaqjen, derisa njëri nga konkurruesit zgjodhi të luante “dyfishimin e vlerës”.

- Bast me tri karamele *Tootsie Roll*, që ajo e humbet, - tha i ati. Kategoria ishte “pajisje cirku” dhe pyetja për “dyfishimin e vlerës” ishte 800\$.

- Në asnjë mënyrë, - u përgjigj Nina. - Bast me dy çokollata *Hershey's Kisses*, që ajo e fiton. Ajo tashmë iu është përgjigjur saktë tri pyetjeve në këtë kategori.

Xhozef Gregori tundi kokën.

- Por ajo ende nuk ka fituar një pyetje 800\$. Njohuritë e saj kufizohen në nivelin 600\$.

Babai i saj këmbëngulte, se shuma e një pyetjeje në lojën *Jeopardy* lidhej me shkallën e vështirësisë, ndonëse Nina nuk ishte krejtësisht e sigurt për këtë. Ai përdorte analogjinë e kësaj loje në jetën reale, kur i duhej të vlerësonte njerëzit. Ndonjëherë, Nina pyeste veten se çfarë niveli kishin njohuritë e saj, sipas mendimit të tij, por druhej ta pyeste. Gjatë gjithë jetës, sa herë kishte bërë diçka, që të atit nuk i kishte pëlqyer shumë, ai i kishte thënë: “Ti je më e zgjuar se kaq”. Këto fjalë gjithnjë e kishin nxitur të përpiquej për të qenë më e mirë, për të punuar më shumë, për t’i menduar gjërat më me kujdes. Por edhe e kishin lënduar... Dhe e kishin futur në mendime, nëse ajo ishte vërtet më e zgjuar se aq, ose nëse babai i saj kishte pritur që ajo të ishte në nivelin 2000\$, por ajo ishte në nivelin 1600\$.

- Kam besim tek ajo, - vërejti Nina.

Hëngri një kafshatë nga pjata e saj me perimet *moo shu*, teksa konkurruesja, një grua e quajtur Zoi, i vuri të gjitha paratë në “dyfishimin e vlerës”.

Pastaj një pyetje me video u shfaq në ekran. “Një version i këtij aparati u zbulua nga i njëjti person, që e bëri popullor kostumin trupor të akrobatit, teksa performonte në skenë me të”, shpjegohej në video.

“Çfarë është një litar i tendosur?”, u përgjigj Zoi.

Nina dhe i ati rënkuan.

- Çfarë është një trapez cirku? - thanë ata të dy njëkohësisht.

“Më vjen keq, por përgjigjja e saktë është: Çfarë është një trapez cirku?”, vërejti Aleks Tribeku. “Dhe ai që e zbuloi ishte Xhuls Liotardi, që e bëri të njohur kostumin trupor.”

- Duhet ta bëjmë vërtet testin, për të marrë pjesë në këtë lojë, - iu drejtua Nina të atit, duke fshehur zhgënjimin që ai kishte pasur të drejtë. Zoi gaboi.

Babai qeshi me zë të ulët.

- S’ka kurrfarë dyshimi që do të fitonim, nëse do të na lejonin të luanim si një skuadër, - vërejti. - Mendoj se më ke borxh ca karamele *Hershey’s Kisses*.

Nina buzëqeshi edhe pse i pikoi në zemër.

- Shtoji te bilanci! - mërmëriti ajo. Babai i saj mbante shënime të përpikta, se kush i detyrohej kujt dhe çfarë lloj karamesh. Hera e fundit, që kishin paguar borxhet e karameleve, ishte kur Nina u largua për në universitet. Të hënat e shfaqjes *Jeopardy* ishin vendosur në pauzë, derisa ajo u kthye në shtëpi, për të filluar shkollën e biznesit në Universitetin e Kolombias. Bilanci i ri kishte dhjetë vjet që vazhdonte.

- Akrobatët janë të jashtëzakonshëm, - vërejt i ati, teksa shikonte Zoin të zgjidhte pyetjen tjetër.

Nina mendoj si mund të ishte të fluturoje në ajër, pa u mbështetur askund. Ajo u drodh.

- Nuk do të mund ta bëja dot ndonjëherë, - mërmëriti.

- Nina ime e kujdesshme, - vërejt babai i saj. - Megjithatë, duhet të përballesh me frikën tënde!

Ajo psherëtiu. Ishte diçka që i ati ia kishte thënë gjithë jetën. “Nuk mund të jesh një biznesmene e mirë, nëse nuk je gati të përballesh me riskun”, i thoshte ai. Dhe ndoshta kjo ishte e vërtetë. Por ndonjëherë, të kishe frikë dukej diçka e zgjuar. Për më tepër, ai e kishte bërë atë të kishte frikë: frikë se ç’do të mendonin njerëzit, frikë se do ta zhgënjente babanë, që ai do të mendonte se ajo nuk ishte në lartësinë e duhur.

- Ti e di që gjithmonë jam përpjekur të të mbroj, - vërejt i.

Kur Nina e vështroi, fytyra e tij iu duk më serioze sesa e priste.

- E di, baba, - iu përgjigj.

- Çfarëdo që të ndodhë, shpresoj mos ta harrosh këtë.

Pyeti veten se çfarë donte të thoshte me këtë, por pastaj momenti kaloi dhe ai vuri bast me një çokollatë *Hershey* për një pyetje 1000\$. Në fillim, Nina mendoj që i ati shqetësohej se ç’do të thoshin njerëzit, kur ai të mos jetonte më. Por pastaj pati përshtypjen që ai po përpiquej t’i tregonte diçka më shumë...

Që ditën kur vajtën me makinën e tij në klubin “Norud”, qëkur u përplasën me njëri-tjetrin te kafeneja dhe prekja e tij e bëri të skuqej, Nina sikletosej kur ishte pranë Rafaelit. Kur ishin në të njëjtën sallë, ajo fiksohej në atë që bënte ai. Vinte re edhe gjërat e vogla, si për shembull: si ai e kafshonte ndonjëherë buzën, kur diçka i dukej argëtuese; si e kalonte dorën e djathtë nëpër flokë, sipër veshit; si sytë e tij shpesh rrëshqisnin drejt syve të saj, sikur kërkonin miratimin për një vendim që sapo e kishte marrë.

Por ata nuk kishin pasur rast të ishin vetëm përsëri, derisa u gjendën së bashku në ashensor, në mesin e qershorit.

- Po më duket si ashensor ekspres, - vërejti Rafaeli, kur po zbritnin kat pas kati, pa ndaluar.

- Diçka e rrallë gjatë orës së drekës, - mërmëriti Nina. Pastaj u struk. “Diçka e rrallë gjatë orës së drekës”. Çfarë komenti i kotë! Nëse nuk do të ishte kaq e druajtur, kur ishte pranë tij, ajo do të kishte thënë: “Gjithnjë kam pyetur veten, pse dikush nuk

e ka zbuluar teknologjinë për të krijuar një ashensor inteligjent, që nuk ndalon, kur është i mbushur me kapacitet të plotë”.

Pastaj Rafaeli ndoshta do t’i kishte treguar për një shkencëtar, që e kishte sjellë në Shtetet e Bashkuara me vizën H-1B, i cili po punonte për diçka të tillë. Dhe Ninës do t’i kishte pëlqyer më shumë kjo bisedë, sesa heshtja e sikletshme që ishte krijuar...

- Ku po shkon? - e pyeti Rafaeli.

- Të marr ndonjë sallatë, - u përgjigj ajo dhe ngriti sytë për ta vështruar. - Nuk e kam vendosur ende. Po ti?

- Dreka e punës m’u anulua në minutën e fundit, - sqaroi ai, duke u mbështetur në mënyrë të shkujdesur në murin e ashensorit. - Dhe dola vjedhurazi, para se Xheini të më jepte diçka tjetër për të bërë. Them ta shfrytëzoj kohën që do të qëndroj jashtë zyrës, për një pushim të shkurtër. Dhe restoranti këtu poshtë më duket interesant. - Pastaj heshti dhe kaloi dorën nëpër flokë. Me sa duket do të thoshte diçka, që edhe mund të kundërshtohet. - Dëshiron të vish edhe ti? - e pyeti.

Nina e dinte, që nuk duhet të shkonte. I duhej të punonte. Por sesi ndihej, kur ishte pranë tij...

- Asnjë presion... - shtoi Rafaeli. - E di që je deri në grykë me punë.

Ashensori ndaloi te holli. Ai bëri mënjanë, që të dilte ajo e para.

- Do të më pëlqente, faleminderit!

Të dy u drejtuan për te restoranti në fund të ndërtesës dhe u ulën te banaku.

- Sa këndshëm është të hash këtu! - tha Rafaeli, pasi të dy kishin porositur. - Unë vendosa një banak të vogël për mëngjes, në apartamentin tim, por Sonia e kishte zët. Më pëlqen të ha i ulur kështu, në stola të lartë.

Nina u çudit, që ai përmendi ish-gruan. Ndoshta ndihej i sigurt, kur fliste për të me Ninën, ashtu si u ndie ajo, kur foli me Rafaelin për babanë e saj. Vrau mendjen, nëse mund ta pyeste më tepër, ta pyeste pse ishin divorcuar. Flitej që një mbrëmje ata dolën për darkë dhe bënë një shëtitje me helikopter nëpër *Manhatan*, për të festuar përvjetorin e tyre të tretë dhe të nesërmen në mëngjes, ajo i tha se donte të ndahej, se kishte kohë që nuk ishte më e lumtur. Tani që e shikonte, Nina nuk arrinte të gjente dot diçka tek ai, që ta bënte një grua të pakënaqur.

- Është disi këndshëm, - mërmëriti ajo. Ndonëse kjo nënkuptonte, që ata ishin ulur përbri dhe jo përballë njëri-tjetrit. Kishte më tepër gjasa, që bërrylat apo kofshët e tyre të prekeshin rastësisht.

- Më vjen keq që nuk do të kesh mundësi të vish në eventin e Lenserave, - vërejti ai, kur u erdhi ushqimi.

- Si është babai?

Nina mblodhi supet.

- Mirë, përgjithësisht. Por vazhdoj të vë re gjëra. Gjëra të vogla. Dhe e di që do të ketë edhe më shumë

të tilla. E di që ato do të shtohen derisa... - Ndjeu një lëmsh në grykë. Por ajo nuk do të qante sërish përpara tij. Veçanërisht në mes të një restoranti.

Rafaeli kishte marrë në dorë sandviçin, por e vendosi sërish në pjatë pa e kafshuar.

- A lexon poezi? - e pyeti.

Nina u gëlltit.

- Jo shumë, - pëshpëriti. - Pak. Kur isha fëmijë, e mësova përmendsh poezinë “Krijesa Xheberuok” për babanë tim.

- *Me shpatën magjike në dorë, në kërkim të armikut të tij të frikshëm,* - citoi Rafaeli.

- *Në pemën “tantum” u ndal të pushonte, për kohën e harxhuar nisi të mendonte,* - e përfundoi Nina.

Rafaeli qeshi.

- Ti je plot surpriza, - vërejti.

“Edhe ti”, donte të thoshte Nina. Por ajo vetëm buzëqeshi dhe e pyeti:

- Përse e përmende poezinë?

- Hëëëm, - u përtyp Rafaeli, duke e zgjatur fjalën.
- Bëra një kurs të shkurtër poezie në universitet dhe që atëherë fillova ta shoh jetën si poezi. Është teoria ime, por më bën të ndihem më mirë për shumë gjëra.

- Çfarë do të thuash me këtë? - e pyeti Nina, duke shpresuar se, çfarëdo që ai do të thoshte, do të ishte ngushëlluese.

- I mendoj njerëzit si poema, - shpjegoi ai. - Ndoshta dikush është “haiku” me tri vargje ose “vilanell”

me nëntëmbëdhjetë vargje, dikush është “sinkein” me pesë vargje, ose një “sonet” me katërmëdhjetë vargje. Gjatësia dhe forma janë të paracaktuara, por jo përmbajtja. Dhe çdo formë ka sfidat e saj, vështirësitë e saj, por edhe bukurinë e saj... Poema e babait tënd po përfundon, por kjo nuk e bën atë më pak të bukur, të vlefshme apo të rëndësishme.

Nina kapsalliti fort sytë, që iu mbushën me lot, por nuk i lejoi t’i rridhnin nëpër faqe; u përqendrua te djathi i skarës. Hëngri një kafshatë dhe shijoi aromën e tij.

- Ke zgjedhur poema për stafin tënd? - e pyeti Nina, pasi ishte gëlltitur dhe kishte shpëtuar nga lotët.

- Hëm, në të vërtetë, jo, - vërejti Rafaeli, duke ngrënë një kafshatë nga sandviçi i tij. - Por mendoj se Xheini është një “limerik” me pesë vargje. Pak e ashpër, por gjithashtu me humor dhe e paparashikueshme.

Nina qeshi.

- Po Maksi?

- Poemë në varg të lirë - u përgjigj ai. - E thellë dhe e fuqishme, por me më pak rimë se poezia. Një krijim i lirë.

- Më pëlqen kjo, - miratoi Nina, ndonëse mund të kishte një ide tjetër për Maksin, që pasqyronte edhe arrogancën apo padurimin e tij. - Për këdo funksionon kjo?

- Nëse e vret pak mendjen, ndoshta çdo njeri mund ta konsiderosh si një lloj poeme, - shpjegoi ai.

- Edhe mua? - pyeti. Fjalët i dolën përpara se ta kuptonte, që ato mund të ishin të rrezikshme.

- Edhe ty, - u përgjigj, duke e vështruar me sytë e tij të zinj që i xixëllonin. “Sharmi i tij është i rrezikshëm”, e paralajmëroi veten Nina. - Mendoj që ti je një “sestina” me gjashtë strofa dhe gjashtë vargje për secilën strofë.

- Kam frikë të të pyes pse, - mërmëriti ajo, duke e vazhduar bisedën, ndonëse e dinte mirë që po gabonte.

Ai qeshi.

- Nuk ka asgjë të keqe. “Sestinat” janë komplekse dhe të ndërlikuara. Edhe ti ashtu je. Ose të paktën, kështu dukesh.

Ajo hëngri një tjetër kafshatë dhe u përtyp ngadalë. Pas pak e pyeti:

- Po ti?

- Mendoj se është e vështirë ta analizosh veten nëpërmjet poezisë, - vërejti Rafaeli, - por unë mund të jem një “gazel”. Më pëlqen ideja e vargjeve çift, të pavarura nga pikëpamja emocionale. Jo çdo gjë që ndiej në njëren pjesë të jetës sime, e ndikon atë në tërësi.

- Pra, ti je një poemë e ndarë në disa pjesë? - e pyeti Nina. Përshkrimi iu duk i vërtetë.

Rafaeli qeshi.

- Them se kjo është një mënyrë për ta përshkruar.

Nina do të dëshironte të dinte si ishin pjesët e tjera të poemës, që ai përfaqësonte...